



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës që të aplikojnë për skemat e përkrahjes në sektorin e bujqësisë, sipas kritereve të përcaktuara më poshtë. Gjithashtu njoftohen të gjithë aplikuesit se mund të jenë përfitues vetëm në njërin nga fushat që do të përkrahen.

1. Furnizimi me makina mjelëse dhe bidona për lopë qumështore, dele dhe dhi.

Kriteret e përgjithshme;

- Të kenë 3 e më shumë krerë gjedhe qumështore;
- Të kenë nga 30 -150 krerë dele qumështore;
- Të kenë nga 20 -150 krerë dhi qumështore;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës, si dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve, deleve dhe dhive të jetë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 3 (tre) vitet e fundit makina mjelëse nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët.

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve, deleve dhe dhive qumështore kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël;
- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga Komuna;
- Të ketë njohuritë elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës (numri i gjedheve, deleve, dhive qumështore);
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (sistemi i bartjes së qumështit);
- Largësia e fermës nga vendbanimi.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse.

2. Furnizimi me laktofrizë, me kapacitet prej 500 L

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve të jetë në territorin e komunës;
- Të kenë 5 krerë e më shumë gjedhe qumështore;
- Gjedhet qumështore duhet të jenë të matrikuara;
- Nuk kanë të drejt përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar në 5 (pesë) vitet e fundit pajisje për ruajtjen e qumështit - laktofriz nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka me qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët;
- Marrëveshja kontraktuese për shitjen e qumështit me qumështore;

Kriteret specifike:

- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve qumështore dhe sasi të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese, kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël të gjedheve qumështore dhe sasisë së dorëzuar të qumështit;
- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet e identifikuar nga komuna;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (vendi i rregulluar për vendosjen e laktofrizit sipas standardeve - dhoma e qumështit);
- Largësia e fermës nga vendbanimi;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Vërtetimi nga shërbimet veterinarë të licencuara nga organet përkatëse;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Marrëveshje me pikën grumbulluese të qumështit (qumështoren) e noterizuar;
- Dëshmi për sasinë e qumështit të dorëzuar në pikën grumbulluese
- Pasqyra financiare për pagesën e qumështit nga ana e qumështores në 3 muajt e fundit;

3. Furnizimi me kultivatorë për fermerë

Kriteret e përgjithshme:

- Përkrahen fermerët të cilët kultivojnë perime në ambient të hapur dhe të mbyllur - serra;
- Aplikuesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Aplikuesi duhet të ketë sipërfaqe të kultivuar me perime në ambient të hapur, së paku 0.20 ha, ndërsa në ambient të mbyllur-serra, së paku 0.05 ha;
- Parcela e mbjellë me perime në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.20/ha e pandarë, ndërsa në serra 0.05ha;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar mekanizëm të njëjtë nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët, në kohëzgjatje për pesë (5) vjet.
- Përfituesit e paisjes (kultivator) janë të obliguar që të sjellin marrëveshjen kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët dhe të noterizuar, në kohëzgjatje për pesë (5) vjet.

Kriteret specifike:

- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Në kushte të barabarta përparësi kanë ambientet e mbyllura - serra
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme-bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Madhësia e fermës do të ketë përparësi, aplikuesit të cilët kanë sipërfaqe më të madhe të kultivuar me perime në raport me ata me sipërfaqe më të vogël dhe atë në kufijtë prej :
 - 0.05-0.20 ha në ambient të mbyllur - serra dhe
 - 0.20-0.50 ha në ambient të hapur;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Infrastruktura përcjellëse (burimi i ujit);
- Fermerët të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të skemave të subvencioneve dhe granteve nga Komuna ose donatorët në bashkëpunim me Komunën, do të kenë përparësi;
- Përparësi do të kenë kultivuesit (fermerët) të cilët kanë, ofrojnë dëshmi - kontrata në lidhje me shitjen e produkteve të tyre për vitin paraprak (2021), si dhe të dëshmoj me faturë të regjistruar ose qarkullim bankar;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, në afat deri në një (1) vit;
- Kopja e planit në afat deri në 1 vit;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Marrëveshja në mes palëve për tokën e marrë me qira e
- Dëshmi - kontrata për shitjen e produkteve.

4. Përkrahje për kultivuesit e bimëve mjekësore-aromatike – pagesa direkte

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës që kultivojnë bimë aromatike – mjekësore, që të aplikojnë për subvencione - pagesa direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

- Fermerët që kultivojnë bimë aromatike – mjekësore, në sipërfaqe prej: 0.15- 3.0 ha;
- Fermerët duhet ta kenë tokën në pronësi të veten;
- Fermerët të cilët e kanë tokën me qira duhet të kenë marrëveshje, në kohëzgjatje për 5 vjet
- Sipërfaqet e mbjella me bimë aromatike - mjekësore, duhet të jenë në territorin e komunës së Prishtinës.
- Parcela e mbjellë me bimë aromatike mjekësore në fushë të hapur duhet të jetë së paku 0.05/ha e pandarë, ndërsa në serra 0.02ha;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin i llogarisë bankare;
- Vërtetimi mbi tatimin në pronë për vitin 2021;
- Certifikata mbi pronësinë, jo më e vjetër se një vit;
- Kopja e planit;
- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kontrata e qirasë mes palëve

Data e aplikimit, prej 15.04. deri më 29.04.2022

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).